

VENDIM
Nr. 406, datë 2.5.2013

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR
TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL E TË SEKRETARIATIT TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, si organ këshillimor në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është i përbërë nga 10 (dhjetë) anëtarë:

- a) Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, bashkëkryetar;
- b) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bashkëkryetar;
- c) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë;
- d) Katër anëtarë, përfaqësues të punëdhënësve;
- dh) Dy anëtarë, përfaqësues të punëmarrësve.

2. Përcaktimi i anëtarëve të Këshillit, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, kryhet nga institucionet përgjegjëse që marrin pjesë në këtë Këshill, me kërkesën e përbashkët të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Këshilli bashkëkryesohet me sistem rotacioni nga Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe bashkëkryetarët e Këshillit:

- a) thërrasin mbledhjet dhe i drejtojnë ato;
- b) caktojnë rendin e ditës, drejtojnë diskutimet, bashkërendojnë punën, sigurojnë zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta;
- c) marrin në konsideratë vendimet e marra përgjatë mbledhjeve të Këshillit dhe orientimet programore, kur ato janë marrë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, pavarësisht nga vlerësimi i tyre individual.

4. Këshilli funksionon si më poshtë vijon:

- a) Këshilli mbledhet mbi bazën e një kalendari, por jo më pak se një herë në katër muaj;
- b) Bashkëkryetarët vendosin për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe;
- c) Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime;
- d) Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit.

5. Këshilli formulon mendime dhe propozime lidhur me:

- a) hartimin e strategjive dhe programeve kombëtare për arsimin dhe formimin profesional, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve nënligjore;
- b) përmirësimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional në përputhje me zhvillimet e sektorëve të ekonomisë dhe interesat e tregut të punës;
- c) projektbuxhetin e parashikuar për AFP-në dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
- ç) standardet për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;
- d) zhvillimin e politikave dhe të programeve të veçanta, të kërkuara nga ministrat përgjegjës dhe

rrugët e financimit të tyre;

dh) informimin e palëve për zhvillimet aktuale dhe perspektive të sistemit të AFP-së;

e) politikat dhe strategjitë e zhvillimit të sistemit të AFP-së;

ë) projektligjet dhe projektvendimet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tij;

f) propozimin e grupeve të përkohshme të punës për çështje të caktuara të zhvillimit të AFP-së;

g) anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të institucioneve të AFP-së.

6. Funksionimi i Këshillit mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).

7. Sekretariati teknik bashkërendon veprimtarinë e Këshillit dhe kryen këto detyra:

a) Organizon mbledhjet e Këshillit dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre;

b) përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim;

c) komunikon me kryetarin e radhës dhe me anëtarët e Këshillit në lidhje me rendin e ditës/ datën, orën dhe vendin e mbledhjes së Këshillit;

ç) shpërndan dokumentacionin e mbledhjes dhe informacione të tjera te anëtarët e Këshillit;

d) mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit;

dh) arkivon dokumentacionin e mbledhjeve të Këshillit;

e) lehtëson funksionimin e grupeve të përkohshme të ngritura nga Këshilli.

8. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapet një faqe e veçantë për veprimtarinë e Këshillit, për të cilin veprohet, si më poshtë vijon:

a) Sekretariati teknik i KAFPK-së merr masat për hapjen e një lidhjeje të veçantë në faqen zyrtare në internet të ministrive për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të AFP-së;

b) Ky sekretariat përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet që mund të bëhen publike;

c) Para publikimit merret miratimi i bashkëkryetarëve të Këshillit.

9. Ngarkohen dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha